



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN



Rruga e Shkronjave nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+383 (0) 29-232-140

Homepage: www.uni-prizren.com

Për:	Këshilli i Fakultetit të Filologjisë
Datë:	06.12.2022
Nga:	Komisioni vlerësues për rishqyrtimin e aplikacioneve të kandidatëve për pranimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Fakultetin e Filologjisë
Cc.	
Lënda:	Rishqyrtimi i propozimit për pranimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Fakultetin e Filologjisë

RISHQYRTIMI I RAPORTIT PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM PËR VITIN AKADEMIK 2022/2023

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës nr.03/L-212, nenin 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës nr.04/L-037 si dhe dispozitat e nenit 47 paragrafi 1.3 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, si dhe bazuar në vendimin e Senatit 01-361 të datës 09.08.2022, dhe të Këshillit të Fakultetit të Filologjisë të datës 11.10.2022 për angazhimin e personelit të jashtëm akademik në bazë të nevojave të njëjësive akademike, komisioni i propozon Këshillit të Fakultetit të Filologjisë këta kandidatë:

Në programin e Gjuhës dhe të Letërsisë Angleze (Semestri dimëror)

3. Një mësimdhënës për lëndët: Anglishtja për qëllime të veçanta II, Gjuhë e huaj II (gjuhë angleze në programin e gjuhës gjermane)

Kandidatët e paraqitur sipas radhës së aplikimit janë:

1. Bajram Demollari
2. Enes Ismeti
3. Arben Shala

Tabela e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm për mësimdhënës

Nr.	Kandidati/ja	Neni 4. pika 2.1			Përvoja në UPZ?	Konflikt interesi, afërsia familjare?	Publikimet shkencore?	Angazhimi sipas Rregullores Nr. 01-17 e datës 28.01.2020
		Grada shkencore Dr. sc.?	Dr. sc. adekuat?	Thirrje akademike në ndonjë Universitet publik?				
1.	Bajram Demollari	Kand.dok.	Po	Jo	Po	Jo	Po	Nuk propozohet për angazhim
2.	Enes Ismeti	Kand.dok.	Po	Jo	Jo	Jo	Po	Propozohet për angazhim
3.	Arban Shala	Kand.dok.	Jo	Jo	Jo	Jo	Po	Nuk propozohet për angazhim

Kandidati kand. dok. Bajram Demollari ka konkuruar pjesërisht për këtë konkurs duke përfshirë vetëm njëren lëndë “Gjuhë e huaj II (angleze)” nga dy lëndët e konkursit. Gjithashtu nuk i plotëson kushtet sipas nenit 6, 2.1 të “Rregullores për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren” të datës 14.01.2022 prandaj nuk propozohet për këtë pozitë.

Kandidati kand.dok. Enes Ismeti i ka kryer studimet themelore në Degën e gjuhës dhe letërsisë angleze, ka magjistruar në Universitetin e Evropës Juglindore – Tetovë, dhe i ka regjistruar studimet e doktoraturës në të njëjtin universitet dhe ka punime të botuara nëpër revista shkencore, prandaj i plotëson kriteret sipas nenit 6, pika 2.1 dhe 3.1 të “Rregullores për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm” dhe propozohet për këtë pozitë.

Kandidati kand.dok. Arben Shala i ka kryer studimet themelore në Kolegjin AAB në fushën e juridikut, dhe në Universitetin e Prishtinës në fushën e shkencave politike, më pastaj studimet master në fushën e gjuhës angleze në Universitetin e Prishtinës. Prandaj kandidati dok. Arben Shala nuk i plotëson kushtet e nenit 5, pika 10, nenit 6, 2.1, 3.1 të “Rregullores për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren” të datës 14.01.2022 prandaj nuk propozohet për këtë pozitë.

4. Një mësimdhënës për lëndët: Letërsi për fëmijë, Letërsi viktoriane

Kandidatët e paraqitur sipas radhës së aplikimit janë:

1. Vjona Sylejmani Shabani

Nr.	Kandidati/ja	Neni 4, pika 2.1			Përvoja në UPZ?	Konflikt interesi, afërsia familjare?	Publikimet shkencore?	Angazhimi sipas Rregullores Nr. 01-17 e datës 28.01.2020
		Grada shkencore Dr. sc.?	Dr. sc. adekuat?	Thirrje akademike në ndonjë Universitet publik?				
1.	Vjona Sylejmani Shabani	Kand. Dok.	Jo	Jo	Po	Jo	Po	Nuk propozohet për angazhim

Kandidatja kand. dok. Vjona Sylejmani Shabani ka përfunduar studimet themelore në Kolegjin AAB në fushën e gjuhës angleze – përkthim, ndërsa studimet master përsëri në Kolegjin AAB. Prandaj nuk i plotëson kushtet sipas nenit 5, pika 10, nenit 6, 2.1, dhe 3.1, të “Rregullores për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren” të datës 14.01.2022 dhe nuk propozohet për këtë pozitë.

Udhëzim Juridik: Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë ankese te Komisioni për ankesa i Fakultetit të Filologjisë, brenda 7 (shtatë) ditësh nga dita e publikimit të këtij raporti.

Komisioni:

1. Prof. asoc. dr. Sermin Turtulla, kryetare

2. Prof. asoc. dr. Teuta Kafexholli, anëtare

3. Prof. ass. dr. Vilson De Marku, anëtar

